



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3133/2 prot

Datë 19.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM

LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT NGRIHEN PRETENDIME.

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-87138-11-10-2023, me objekt: “Blerje mobileri për shkollën 9 vjeçare “Azem Hajdari” Zall Mner” me fond limit 7,944,467 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KLAME” SHPK, *me Nipt K21518003F dhe adresë: Rr. Gani Kryeziu, Nr. 23, Kati II, Njësia Administrative 11, Kodër, Kamëz.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”nr. 492, Kamëz. Tiranë
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “ERALD” SHPK, me Nipt. J74517205P, *dhe adresë: Rruga Nacionale Tiranë–Fushë Krujë, km 13, ndertese private 1 kateshe, zona kadastrale 3096 , Nikel, Qereke, Durrës.*

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me numër ankimi elektronik A/2023/3689, datë 18.12.2023 dhe me nr. 3133/2023 prot., datë 18.12.2023 e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-87138-11-10-2023, me objekt: “Blerje mobileri për shkollën 9 vjeçare “Azem Hajdari” Zall Mner” me fond limit 7,944,467 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK në ankesën me nr. 3133 prot., datë 18.12.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “ERALD” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje të kriterëve si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

(Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **158,889** (njqind e pesedhjetë e tetemije e teteqind e tetedhjetë e nente)leke.)

2.2.2. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3(tre)viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

Shëmin:Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për

auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/ distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:*

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

b) ISO 14001:2015, ose e përditësuar lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit

2.3.7. *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 1 (një) mjet transporti me peshë mbajtëse min 1.5 Ton të përshatshëm për transport mobiljesh. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.*

Pronësia e mjeteve të mësipërme vërtetohet:

e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

2.3.8. *Operatorët ekonomik duhet të paraqesin mostrat e cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor.*

Lista e mostrave që duhet të paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhëna në DST, të jenë:

- **Moster 1 (një) copë “Tavolinë nxënësi CU” (120x64x45)**
- **Moster 1 (një) copë “Karrige nxënësi CU” (35x38x37/70)**
- **Moster 1 (një) copë “Tavolinë nxënësi AMU” (120x75x45)**
- **Moster 1 (një) copë “Karrige nxënësi AMU” (35x38x42/75)**

Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave, është kusht skualifikues
(Dorëzimi i mostrave do të bëhet me procesverbal)

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 19.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro